VENDIM
Nr. 746, datë 5.9.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 378, DATË 12.8.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË PRONARIT PËR DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 7926, datë 10.5.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e objekteve për të cilat kalohet e drejta e përfaqësuesit të pronarit për pronën shtetërore tek organet e qeverisjes vendore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 378, datë 12.8.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, hiqet nga Ndërmarrja e Uzinës Mekanike Bujqësore Korçë aseti "Reparti i kombinuar", privatizuar nga ish-shoqëria Vefa Holding sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha